



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.16, datë 12.10.2022

PËR

**SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE RINOVIMIN E LEJES  
NR.SERIE 00009, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.39, DATË  
22.02.2017 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR,  
SUBJEKTIT “A-KLAS-BETONASFALT” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 112, të Kodit të Proçedurave Administrative, pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatave të lejes Nr.Serie 00009, miratuar me Vendimin Nr.39, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat si më poshtë:

Vendndodhja e pus shpimit me koordinata do të saktësohen:

Nga: X= 4389248; Y= 4618442; (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=4389264; Y=4618403; Z= 9 m.m.n.d (ALBANIAN 1986/GK4)

Në : X=472383; Y=4617467; Z= 9 m.m.n.d (KRGJSH)

- Sasia e ujit që jepet në përdorim: Q=0.5 l/s

- Prurja mesatare :  $Q_{mes} = 2 \text{ l/s}$
- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Gropë septike

2. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes Nr.Serie 00009, miratuar me Vendimin Nr.39, datë 22.02.2017 të Këshillit të Basenit Ujor Mat, “leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë teknologjik (prodhim betoni)”, sipas koordinatave të mësipërme të saktësuara me vendodhje, fshati Gajush, bashkia Lezhë.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBUS MAT**

**GJERGJ PRENDI**

